

Tiranë, 6 janar 2020

I dashur miku im, Vasil S. Tole ,

Po ndaj me ju disa përshtypje si lexues i thjesht për librin “Një jetë mes dy shekujve-kujtimet e babait” botuar vitin e kaluar . Ky është libri i mençurisë , i urtësisë njerëzore , që të meson ca gjëra kryesore në jetë që të bëhesh njeri i mirë..

Jeta e atit tuaj Sofokli V. Tole është një varg margaritaresh të kultivuara në Lupckë dhe të përcejell brez pas brezi. Nga libri mësova mjaft gjëra me vlerë . Mësova se jeta e vërtetë është jeta e punës, e ndershmërisë, e përkushtimit ndaj familjes si qeliza e jetës shoqërore.

Gjyshi juaj, Vasili kishte mbaruar gjimnazin e famshëm të Zosimes me rezultate të shkëlqyera dhe zotronte disa gjuhë të huaja kryesore si greqishten, anglishten, frëngjishtes, turqishten, italishten e tj.

Në një hark kohor 60-vjeçar, ati juaj, përshkruan gati me detaje sfidat e jetës dhe kapërcimin e tyre me dinjitet dhe nder. Ka mjaft pjesë të shktuara me frymëzim lirik sidomos njohja me vajzën-thëllëzë të Ndëranit, me shikimin e parë, kur kishte zbritur në Përmet.

Ai bëri një jetë aktive sa për familjen, po aq për shoqërinë dhe atdheun. U kujdes në mënyrë të veçant për shkollimin tuaj edhe duke “ju shkullur veshin” ! ndonjëherë. Kudo punoi me nder dhe u vlerësua.

Ky libër më ndihmoi të kuptoj edhe më thellë kodin shpirtëror e qytetar të mikut tim: bardhësinë e shpirtit, drejtësinë, pastërtinë intelektuale dhe energjinë e pamasë për artin , muzikën dhe shkencën.

Parathënia e librit e shkruar me dashuri, me adhurim njerëzor dhe qiellor , ngjan si një uverturë e një nga kompozimeve tuaja orkestrale.

Përgëzime për këtë libër plot mençuri!Te lutem pranoni këto shënime thjesht si një lexues librash .

Miqësisht

Prof. Agron F. Fico